

## VEND I LIRË PUNE

### EDUCATION & MEDIATION MANAGER, CENTRE FOR NARRATIVE PRACTICE

Qendra për Praktikë Rrëfyese u ndërtua si një institucion nga Manifesta 14 Prishtina, ngjarje që u mbajt në Kosovë gjatë verës e deri në vjeshtën e vitit 2022. Misioni i Manifesta 14 ka qenë gjithmonë ndërtimi i një institucioni të qëndrueshëm për dhe me qytetarët e Prishtinës. Qendra do t'i shërbejë komunitetit artistik, studentëve dhe punëtorëve të kulturës si një hapësirë për risi artistike, bashkëprodhim, mësim dhe ndërtim të rrjetit profesional prej pranverës së vitit 2023 deri në vjeshtën e vitit 2026 në Prishtinë, Kosovë dhe do të udhëhiqet nga Bordi i Manifesta 14 Prishtina. Anëtarët e përzgjedhur të ekipit do të punojnë për gjashtë muaj, me mundësinë e kohëzgjatjes së punës për 3.5 vite der në përfundim të vitit 2026.

Qendra për Praktikë Rrëfyese (CNP) synon të ndërtojë aftësi duke ofruar burimet dhe mjetet për të mësuar, hulumtuar, ndarë dhe transferuar aftësitë në fushat e industrive krijuese. Qendra për Praktikë Rrëfyese me vetëdije dhe në mënyrë pro aktive sfidon paramendimin se mendimi dhe praktikat artistike janë fushë veprimi për të privilegjuarit, qëllimi po ashtu është të zgjerojë qëllimin dhe të krijojë qasje të gjërë për të gjitha audiencat. CNP synon të forcojë artet, kulturën dhe sektorin publik duke ofruar hapësirat aq të nevojshme apo mjediset, mjetet, pajisjet dhe aftësitë për të gjithë.

Qendra për Praktikë Narrative kërkon një Menaxher të Edukimit dhe Ndërmjetësimit të motivuar dhe me përvojë nga Kosova. Menaxheri i Arsimit dhe Ndërmjetësimit është përgjegjës për krijimin e projekteve dhe strategjive për të punuar dhe për t'u lidhur me komunitetet dhe kolektivat e ndryshme të Kosovës, me fokus të veçantë në arsimin formal dhe arsimin joformal, studentët dhe komunitetet më vulnerabël.

## KOHËZGJATJA DHE STATUSI

Dita e fillimit	1 janar 2023
Pozitë me kohë të plotë	Duke përfshirë mbrëmje dhe fundjava të caktuara
Vendndodhja e punës	Prishtinë, Kosovë
Koha e provës	6 muaj
Orët	40 orë në javë.

### Përgjegjësitë primare

Menaxheri i Edukimit dhe Ndërmjetësimit ndërton marrëdhënie të forta me rrjetet vendore, duke përfshirë nisma të ndryshme dhe shoqatat civile, komunitetet e lagjeve, shkollat dhe institutet e tjera formale të arsimit, skenën lokale të artit dhe punonjësit e kulturës. Qëllimi i programit të Edukimit dhe Ndërmjetësimit është të lehtësojë hapësirat për njohuri alternative, duke njohur rëndësinë e tyre për kulturën dhe arsimin.

## DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

### Edukimi & Ndërmjetësimi

- Zhvillimi i programeve të Edukimit dhe Ndërmjetësimit në Qendër.
- Zhvillimi i rrjetit vendor dhe bashkëpunëtorëve në hapësira të edukimit joformal, në kulturën bashkëkohore dhe shoqërinë civile.

- Mbikqyrja e zhvillimit dhe zbatimit të programeve kulturore për të gjitha llojet e kolektivëve, moshave dhe komuniteteve.
- Ngritja e proceseve dhe mjeteve të punë për një mbarëvajtje të qetë dhe të shëndetshme në ekipet e Edukimit.
- Krijimi i projekteve që nxisin punën me grupe dhe komunitete në situata të vulnerabilitetit apo përjashtimit shoqëror, të dizajnuara duke iu përshtatur nevojave të tyre dhe të zbatohen pa ushtruar dinamika paternaliste.
- Të ndërtojë ura komunikimi me organizata joqeveritare dhe kolektive të ndryshme.
- Të mbështesë projekte dhe aktivitete me komunitetet minoritare si roma, ashkali dhe egjiptane.
- Të mbështesë një strategji të zhvillimit të audiencave për të përfshirë komunitete të ndryshme kosovare në programin e Qendrës për Praktikë Rrëfyese.
- Të plotësojë detyra të tjera që kërkojnë mbështetjen e anëtarëve të tjerë të Ekipit të Menaxhimit.

## AFTËSITË DHE EKSPERIENCA E KËRKUAR

### Edukimi & Ndërmjetësimi

- Të ketë interes të gjërë, përvojë praktike dhe qëndrim kritik në një ose disa fusha: punë në komunitet, muzeologji, kultura bashkëkohore, sociologji ose fusha të tjera të ngjashme.
- Të flasë rrjedhshëm gjuhën shqipe dhe angleze të shkruar dhe të folur, njohja e gjuhës serbe është një plus.
- Të ketë aftësi për të njohur dhe vlerësuar diversitetin.
- Të ketë dëshirë të zhvillojë, të mësojë dhe përvetësojë aftësi dhe metodologji të reja ndërmjetësimi.
- Të ketë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe entuziazëm të vërtetë për ndërtimin e bashkëpunimeve dhe partneriteteve.
- Të ketë njohje të mirë të praktikave të edukimit dhe të ndërmjetësimit në Kosovë.
- Të ketë përvojë në koordinimin e projekteve arsimore dhe socio-kulturore.
- Të ketë aftësi të shkëlqyera organizative dhe të punës në grup.
- Të jetë i ndërgjegjshëm dhe i ndjeshëm ndaj konteksteve të ndryshme sociale dhe kulturore.
- Të jetë bashkëpunues, me aftësi drejtuese, ndërsa është i aftë të punojë me drejtimin e menaxhmentit.
- Të ketë përvojë në përgatitjen dhe monitorimin e buxheteve.

### SHPËRBLIMI

Pagesa përcaktohet në varësi të eksperiencës.

Si të aplikohet për këtë pozicion pune?

Ju lutemi të na dërgoni aplikimin tuaj për punë dhe CV, të dyja në gjuhën angleze duke iu referencuar në subjekt: Education and Mediation Manager Centre for Narrative Practice nënë [m14jobs@manifesta.org](mailto:m14jobs@manifesta.org) deri më 15 dhjetor 2022.

Kandidatët e suksesshmëm do të ftohen në intervistë.